



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.09.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve për mbledhjet e datave 18.06.2019 , 16.07.2019 dhe 03.09.2019.

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri – Kosovë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017”.

3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Anastas Angjeli, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Artemis Dralo (Malo), Blerina Gjylameti, Senida Mesi, Ervin Bushati, Vullnet Sinaj, Reme Lala, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Krenar Ryçi dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Arben Elezi, Evis Kushi dhe Korab Lita.

Të ftuar:

Erjon Luci – Zëvendësministër i Financave

Tedi Bushaj – përfaqësues i Ministrisë së Financave

Enkelejda Hitaj – përfaqësuese e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Sokol Dedja - Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Gentian Xhaxhiu – përgjegjës sektori në Drejtorinë e Fondeve të BE-së.

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e komisionit. Sot kemi 3 pika në rendin e ditës: pika e parë është miratimi i procesverbaleve për mbledhjet e datave 18.06.2019, 16.07.2019 dhe 03.09.2019. Ka ndonjë koment apo opinion për këto procesverbale? Nuk ka!

Miratohen.

Pika e dytë është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit nëpërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar “IPA II Shqipëri-Kosovë, 2014-2020”, alokimet e vitit 2017”. Relator i këtij projektligji është zoti Roland Xhelilaj.

Pika e tretë është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”. Relator i këtij projektligji është zoti Vullnet Sinaj.

Të ftuar nga Ministria e Financave kemi zëvendësministrin Erion...

Nuk ndodhen këtu përfaqësuesit e Ministrisë së Financave?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sokol Dedja, zëvendësministër dhe Gentian Haxhiu, përgjegjës sektori në Drejtorinë e Fondeve të BE-së.

Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit nëpërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Shqipëri-Kosovë, 2014-2020”, alokimet e vitit 2017”.

Zoti Roland, fjala për ju.

Roland Xhelilaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Shqyrtimi i këtij projektligji bëhet në cilësinë e komisionit përgjegjës nga Komisioni ynë i Ekonomisë dhe është në zbatim të neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit, neneve 78, 83, pika 1, dhe nenit 121 të Kushtetutës së Shqipërisë.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, kreu II “Marrëveshjet ndërkombëtare”.

Projektligji ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes së financimit nëpërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European për programin e veprimit të

bashkëpunimit ndërkufitar IPA II Shqipëri-Kosovë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017. Sipas kësaj marrëveshjeje, UNION-i ka rënë dakord të financojë alokimet për vitin 2017.

Kostoja totale e vlerësuar për alokimet e vitit 2017 të këtij programveprimi është afro 1 milion euro e 988 mijë e 235 dhe maksimumi i kontributit të UNION-it për këtë program është 840 mijë euro. Kjo shumë është granti i BE-së bazuar në instrumentin e asistencës para aderimit.

Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë është miratuar nga komisioni me vendim zbatues në dhjetor të vitit 2014. Marrëveshja e financimit është nënshkruar nga pala shqiptare në tetor të vitit 2018 dhe nga pala kosovare në dhjetor të vitit 2018. Programi i miratuar përbën strategjinë e bashkëpunimit për rajonin kufitar, duke përcaktuar midis të tjerash listën e zonave gjeografike të lejuara, kontekstin e zonës, prioritetet tematike të programit dhe alokimet treguese buxhetore për periudhën 7-vjeçare.

Objektivi i programit është të ketë projekte të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit, promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, burimeve të energjisë së rinovueshme dhe ndryshimin drejt një ekonomie me karbon të ulët dhe të sigurt, gjithashtu, sigurimi i zbutjes së fatkeqësive dhe zhvillimi i sistemit të menaxhimit dhe gatishmërive në raste emergjente, projekte të përbashkëta për të inkurajuar turizmin dhe për të promovuar trashëgiminë kulturore dhe natyrore, projekte të përbashkëta edhe për hartimin dhe zbatimin e skemave të arsimit dhe trajnimit profesional për mbështetjen sidomos të iniciativave rinore.

Zona e programit ndërkufitar mbulon një territor prej 8335 kilometrash katrorë me një popullsi që shkon rreth 936 mijë e 761 banorë, nga të cilët 76 % jetojnë në territorin e Kosovës dhe 24 % në zonën shqiptare, që përfshihet në këtë program.

Gjatësia e zonës kufitare është 114 kilometër. Në Shqipëri përfitojnë rajonet e Kukësit dhe Lezhës, 8 bashki me një total 362 vendbanime duke mbuluar 48 % të zonës së programit, kurse 52 %, domethënë 12 bashki, janë në pjesën e Kosovës.

Projekte të përbashkëta mund të ndërmerren për të krijuar një rrjet të formimit profesional dhe për të nxituar bashkëpunimin mes të gjitha institucioneve, pushtetit vendor e me radhë.

Rezultatet e pritshme të këtij planveprimi konsistojnë në një menaxhim më të mirë dhe promovim të burimeve mjedisore dhe biodiversitetit, përmirësim dhe bërjen më të konkurueshme në cilësinë e shërbimeve të produkteve të turizmit, si dhe mbrojtjen më të mirë dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, historike natyrore.

Së treti, edhe përmirësimin e qasjes në arsim për të forcuar aftësitë për të përmbushur kërkesat e tregut të punës, gjithashtu, qëllim është edhe rritja e shkëmbimit dhe bashkëpunimit midis të rinjve dhe të rriturve.

Objektivat janë: fushatat e ndërgjegjësimit mjedisor me një ndërhyrje të vogël në përmirësimin e strukturës, ndërhyrjen në një shkallë të vogël rikonstruksioni modernizimi dhe restaurimi për të lehtësuar tërheqjen turistike ku përfshihen: harta turistike, integrimi i trashëgimisë e të tjera me radhë dhe iniciativa të vetëpunësimit dhe fuqizimit të rinisë me mbështetje të fillimit të bizneseve të reja, të iniciativave të përbashkëta për të parandaluar braktisjen e shkollës me kurikula të përbashkëta dhe programe të trajnimit profesional dhe arsimor për këto gjenerata. Ashtu siç jua thashë edhe më sipër, përfitues janë autoritetet lokale, institucionet, shoqatat e bashkive, SME-të, organizatat turistike kulturore e të tjera me radhë.

Periodha e ekzekutimit të kësaj marrëveshjeje është caktuar të jetë 12 vjet nga hyrja në fuqi, ndërsa periodha e zbatimit operacional të saj është 6 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje financiare. Për zbatimin e këtij projektligji është ngarkuar Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme në cilësinë e saj si koordinatorë kombëtarë e asistencës së BE-së në Shqipëri.

Duke marrë parasysh se përfitimi i të dyja vendeve do të jetë përafërsisht i barabartë pritet që vendi ynë të marrë pjesën më të madhe të 840 mijë eurove që do të alokohen. Raporti i financimit të çdo projekti nga kjo marrëveshje është në 85% grant i BE-së dhe 15% bashkëfinancim kombëtar.

Duke vlerësuar ratifikimin e kësaj marrëveshjeje si relator u kërkoj kolegëve të komisionit ta miratojnë atë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Zoti zëvendësministër, keni ndonjë gjë për të shtuar përveç atyre që tha relatori? Jo.

Faleminderit!

A ka ndonjë nga koment nga anëtarët e komisionit ndonjë koment apo pyetje? Nuk ka.

Roland Xhelilaj – A mund të bëj një pyetje?

Arben Ahmetaj – Zakonisht relatori nuk bën pyetje, gjithsesi ju mund ta bëni pyetjen tuaj.

Roland Xhelilaj – Nuk po e bëj pyetjen.

Arben Ahmetaj – Do ta thyejmë edhe një herë rregullin, relatori bën pyetje.

Roland Xhelilaj – Pyetja ime ka të bëjë me datën e nënshkrimit të marrëveshjes, të hyrjes në fuqi dhe të kryerjes financiare të alokimeve?

Kosova e ka miratuar më 31 dhjetor 2018 dhe në të thuhet: “Kjo marrëveshje duhet të ratifikohet para datës 31 dhjetor 2018”. A na krijon neve kjo gjë probleme apo jo?

Sokol Dedja – Faleminderit për pyetjen!

Afati 31 dhjetor 2018, në fakt, është për nënshkrimin e marrëveshjes. Nënshkrimi është bërë tashmë nga të dyja vendet, edhe nga Komisioni European, kuptohet pas miratimit në parim nga Këshilli i Ministrave. Ajo që dua të theksoj është që me ratifikimin e marrëveshjes financiare Kuvendi miraton alokimet financiare të vitit 2017 për këtë program dhe kjo i hap rrugën zbatimit konkret të projekteve, i cili nuk ka filluar ende. Fondet e këtij viti, të vitit 2017 së bashku me fondet e vitit 2016 do të përdoren për një thirrje që është hapur, është hapur thirrja për projekte në maj të këtij viti, është kryer procesi i aplikimeve, i cili ka përfunduar më 31 gusht të këtij viti. Pra, shumës prej 840 mijë euro të këtij viti do t'i bashkohet e njëjta shumë e vitit të shkuar, plus bashkëfinancimi kombëtar dhe do të financohen projekte për një shumë prej 2,2 milionë euro.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Vetë titulli i projektligjit është ratifikim, kështu që praktikisht procedura është bërë dhe ky është hapi final i procedurës.

Kalojmë në votimin e ligjit në parim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim në votim ligjin në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Falënderoj relatorin dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme, se u lodhët!

Kalofshi sa më mirë!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 11.09.2019, ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – Kryetar i Komisionit

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Anastas Angjeli, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Artemis Dralo (Malo), Blerina Gjylameti, Senida Mesi, Ervin Bushati, Vullnet Sinaj, Reme Lala, Edlira Hyseni, Artur Roshi, Suzana Topi, Krenar Ryçi dhe Sadi Vorpsi.

Mungojnë:

Arben Elezi, Evis Kushi dhe Korab Lita.

Të ftuar:

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj - Përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Enkelejda Hitaj – Përfaqësuese e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arben Ahmetaj – Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin

Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”, për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Relator i këtij projektligji është zoti Vullnet Sinaj.

Zoti Vullnet, fjala për ju.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, kryetar!

Projektligji që do të diskutojmë dhe miratojmë ka të bëjë me ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin lehtësimi i tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza. Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së huas në shumën prej 17 600 000 euro, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor. Ky projekt është miratuar nga Banka Botërore me qëllim përmirësimin e lidhjeve tregtare dhe integrimin ekonomik të Ballkanit Perëndimor brenda rajonit dhe në Bashkimin Europian. Objektivi kryesor i projektligjit është ulja e kostove të tregtisë dhe rritja e efikasitetit të transportit përmes një angazhimi afatgjatë dhe të vazhdueshëm. Projekti është pjesë e fazës së parë të një programi të përbashkët rajonal për vendet e Ballkanit Perëndimor, i cili synon të lehtësojë arritjen e qëllimeve të qeverive përkatëse të këtyre vendeve për të ulur kostot e tregtisë dhe rritjen e efikasitetit të transportit përmes angazhimit afatgjatë dhe të vazhdueshëm.

Programi përfshin dy faza, të cilat do të zbatohen për një periudhë 5 vjet secila.

Faza e parë mbulon tre vende të Ballkanit Perëndimor, Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë, të konsideruara gati për zbatim.

Faza e dytë përfshin tre vende të tjera të rajonit, Bosnjë-Hercegovinën, Kosovën dhe Malin e Zi.

Realizimi i këtij programi është organizuar në tri pjesë.

1. Lehtësimi i lëvizjes ndërkufitare të mallrave. Kjo pjesë synon në projektimin dhe instalimin e *National Single Window*, që bën të mundur komunikimin elektronikisht midis autoriteteve doganore dhe të gjitha institucioneve kombëtare që lëshojnë leje, licenca, autorizime, të cilat janë të domosdoshme për kryerjen e procedurave doganore në import-eksport të mallrave. Kjo sjell uljen e kohës së zhdoganimit, uljen e kostove, për bizneset lehtësi dhe transparencë.

2. Ofrimi i mbështetjes për përmirësimin e kapaciteteve fizike dhe kushteve të punës në pikën kufitare të Qafë-Thanës, duke ndërtuar një pikë të përbashkët kontrolli me shtetin e Maqedonisë së Veriut. Nëpërmjet konceptit “*one stop shop*” të projektit të Bankës Botërore

synohet të përmirësojmë infrastrukturën dhe shërbimet në këtë pikë të kalimit kufitar duke ndërtuar këtë pikë të përbashkët.

Ky projekt parashikon kryerjen e punimeve në objektet ekzistuese duke përfshirë ndërtesa, sistemimin e shërbimit të informacionit midis objekteve kufitare, objekteve doganore, porositë hyrëse dhe dalëse dhe vendparkimet e kamionëve, instalimin e një peshoreje shtesë në pikën e kalimit kufitar, përmirësimin e infrastrukturës elektronike dhe infrastrukturës së sistemit të zhdoganimit të mallrave.

Pjesa e dytë është rritja e efikasitetit dhe parashikueshmërisë së transportit, ku përfshihet përgatitja dhe projektimi i një sistemi inteligjent të transportit për sektorin detar.

Ky sistem do të monitorojë trafikun e anijeve, ku do të përgatitet një studim për instalimi e pajisjeve për menaxhimin e trafikut të anijeve përgjatë vijës bregdetare të Shqipërisë. Ky sistem përbëhet nga sistemi i menaxhimit të portit, sistemi për sigurinë e portit, sistemi mbështetës dhe menaxhimi i pilotimit, sistemi i administrimit të ngarkesës etj.

3. Pjesa e tretë është mbështetja për menaxhimin e projektit, ku përfshihet mbështetja e njësisë zbatuese të projektit dhe ofrimi i mbështetjes teknike shtesë, duke përfshirë koordinimin e politikave, monitorimin edhe vlerësimin e projektit.

Ky projektligj është përgatitur nga strukturat përkatëse pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila është edhe pjesë në zbatimin e këtij projekti së bashku me Ministrinë e Infrastrukturës dhe të Energjisë dhe me Ministrinë e Brendshme.

Ky projekt pritet të ketë edhe efekte financiare, pasi kompjuterizimi dhe thjeshtësimi i procedurave do të mundësojnë që kompanitë e vendosura në Shqipëri të përballojnë më me efektivitet sfidat e globalizmit ekonomik dhe rritjen e evoluimit të tregtisë.

Parashikohet që uljet e kostove vjetore të import-eksportit të jenë më shumë se 10%.

Siç ju thashë, shuma totale është 17 600 000 euro. Afati i maturimit është 23 vjet, duke përfshirë këtu edhe 7 vjet, që nuk do të paguhet principal.

Në fakt, unë jam ndalur pak për të kuptuar të gjithë së bashku rëndësinë që ka ky projekt në dy të dhëna të një studimi të BB-së, e cila ka dalë në konkluzionin që vonesat në pikat kufitare të Ballkanit Perëndimor janë 5 herë më të mëdha se vonesat në pikat kufitare të Europës dhe si rezultat i qëndrimit të kamionëve ndezur në këto pika kufitare për efekt të kësaj kohe të gjatë, kemi rreth 26 milionë orë pune ose rreth 3 mijë vjet punë, sikur kamionët janë në punë vetëm nga qëndrimi në këto pika duke çliruar edhe gazra në natyrë dhe me këtë projekt ulim rreth 30 mijë tonë çlirimin e këtyre gazrave në natyrë.

Duke parë rëndësinë e madhe që ka ky projekt i BB-së, ku Shqipëria bën pjesë bashkë me vendet e tjera të rajonit, ju ftoj ta votojmë pa asnjë hezitim!

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Zëvendësministër!

Erjon Luçi – Dua të theksoj se ky është një projekt relativisht novator, iniciuar nga Shqipëria për një nivel rajonal.

Ky është projekti i parë, ndërsa një projekt i dytë do t'ju vijë shpejt për barazinë gjinore. Mbështetja buxhetore do të jetë shumë shpejt në komision, pikërisht për faktin se CEFTA, iniciativat e tjera ballkanike dhe procesi Berlinit do ta mbështesin. Pra, ky është me të vërtetë një projekt i veçantë në aspektin e mënyrës se si angazhohet BB-ja apo edhe ne me vendet e tjera të rajonit.

Është si projekt i parë në botë edhe ky, edhe ai i barazisë gjinore, që po zbatohen nga BB-ja, prandaj doja të theksoja këtë fakt.

Arban Ahmetaj - Faleminderit!

Urdhëroni me pyetjet që kishit, zoti Roshi!

Artur Roshi – Aty flitet për koston e projektit. Pyetja ime është: Meqenëse ne jemi në fazën e parë, dhe bëhet fjalë për 3 vende të rajonit, ne kemi 1/3 e koston? Si është llogaritur kjo kosto?

Cila është njësia matëse me të cilën ju do të masni rritjen e performancës pas përfundimit të këtij projekti? Si do ta kuptojnë qytetarët ose si do të vijë në perceptimin publik?

Maqedonia e Veriut dhe Serbia të njëjtën masë projekti kanë me ne?

Urdhëroni, zoti Sinaj!

Vullnet Sinaj - Nga ky projekt a do të përfitojnë edhe makinat e vogla që lëvizin në kufi për të shpejtuar procesin e kalimit në dogana?

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zoti zëvendësministër!

Dua të theksoj se ky është projekti i parë që BB-ja e provon me shtetet e ndryshme. Është projekt jonacional, por është rajonal dhe është në referencë të asaj analize, që me të drejtë Vullneti iu referua, të BB-së, por edhe të procesit të Berlinit, ku lehtësimi i tregtisë është një nga shtyllat e integritit ekonomik-rajonal, që preket jo më nga një institucion, jo thjesht nga komisioni, jo thjesht nga banka, jo thjesht nga CEFTA, por nga të gjitha institucionet dhe nga vendet pjesëmarrëse. Komponentët janë shumë interesante dhe besoj se ju e keni studiuar këtë pjesë. Në fund, pyetjes që bëri zoti Roshi, unë nuk marr përsipër t'i përgjigjem për shkak të funksionit si kryetar komisioni, prandaj do t'i përgjigjet zëvendësministri. Pyetja ishte si matet performanca dhe ishte një pyetje e drejtë.

Në fund, pasi projekti të jetë në një fazë të avancuar, do të jemi në gjendje që edhe kur komponentët të jenë ushtruar përtej 50, 60 apo 70 përqindëshit të tyre, të shohim përmirësim qoftë në orët e punës të harxhuara, qoftë në volum, qoftë në shpejtësi, qoftë në procedura apo në informacion, sepse projekti ka një komponent shumë interesant të shkëmbimit të informacionit që besoj se autoritetet dhe jo vetëm ato, por edhe aktorët ekonomikë privat, do të jenë në gjendje ta përdorin si matanë kufirit ashtu dhe këtej.

Po, zoti Zëvendësministër!

Erjon Luçi – Në terma rajonale ky është një projekt ku faza e parë kushton rreth 90 milionë euro dhe 40 milionë euro faza e dytë, kështu që kostoja e Shqipërisë është relativisht normale, nuk dua të them modeste.

Synimi dhe nxitja kryesore e këtij projekti është pikërisht ulja e koston në bazë të studimeve që përmendi edhe zoti Sinaj, por është bazuar edhe në një studim të OECD-së, që ka vlerësuar se kursimet ose kostot nga procedurat doganore dhe vonesat në këto pika kufitare janë 2.8 ose 4.2 % në vendet në zhvillim. Me një llogaritje të thjeshtë, që kanë bërë për uljen e numrit të letrave, të orëve, të benzinës, që u përmend pak më parë, dhe të shpejtësisë me të cilën procesohet kalimi i pasagjerëve apo i jotregtarëve, arrin një vlerë kohore të parasë për 10 vjet (jo për 23 vjet që zgjat projekti), rreth 131 milionë euro. Kjo do të thotë se pritet që vendi të përfitojë 131 milionë euro nga një investim prej rreth 10 milionë eurosh, që është komponenti i parë.

Komponenti i dytë është pak më modest, gjithsesi edhe ai ka një 5 milionësh euro përfitim. Mund të themi që ky është një projekt, i cili pritet t'i sjellë ekonomisë shqiptare në 10 vjet 135-140 milionë euro, sepse këto përfitime vazhdojnë edhe pas 10 vjetëve. Kjo është bërë edhe duke goditur zbatimin të themi me 20% të rritjes së koston apo 20% të ardhura pak më të ulëta ose mosarritja e disa objektivave të uljes së orëve të qëndrimit apo të uljes së numrit të procedurave dhe letrave. Kështu që deri diku do të kapet edhe nga *doing business*.

Arben Ahmetaj – Patjetër. Një pjesë e procedurave doganore patjetër që do të kapen nga *doing business*, por besoj se indirekt do të përmirësojë *doing business* edhe me *window information* që do të ofrojë për aktorët.

Ajo që tha zëvendësministri është që raporti me kosto-përfitim është serioz në favor të përfitimit, jo thjesht në perceptim apo në kohë, por edhe në kosto. Në fakt, të gjitha aty përmblihen, procedurat, koha, përmirësimi etj. Unë e kam negociuar vetë me zëvendësministrin kur isha në Ministrinë e Financave dhe për mua është një nga projektet më inovative që BB-ja ka negociuar me vendet.

Faleminderit!

A ka ndonjë pyetje tjetër? Nuk ka.

Faleminderit Landit dhe Vullnetit për relatimet!

Kalojmë në votimin në parim.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë votimin nën për nën.

Te neni i parë kam një ndryshim. Keni vendosur shumën në nën, por nuk është e nevojshme, sepse ju thoni: "...sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij". Unë rekomandoj që pjesa ku përmendet shuma 17.6 milionë euro të bjerë dhe neni të riformulohet kështu: "...sipas tekstit që i bashkëngjitet ligjit dhe është pjesë përbërëse e tij".

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Hyrja në fuqi.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit zoti zëvendësministër!

Faleminderit kolegëve dhe relatorëve!

Këtu mbyllet mbledhja.

Ju uroj ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti